



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 97 Prot.,

Tiranë, 26.04 2024

VENDIM

Nr. 82, datë 26.04.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 26.04.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Hartografimi dhe Dokumentimi i zonave arkeologjike duke përdorur Teknologjitë e avancuar GIS, DRON, LIDAR dhe Laser Scanner”, me aplikues dhe zhvillues Fakulteti Gjeologji Miniera;
2. Raporti i rezultateve dhe dokumentacioni teknik të depozitohen pranë IKTK dhe DRTK Korçë, në përputhje me VKM Nr. 220, datë 7.4.2021 “Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike, të kushteve të posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike”;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

